

REZOLUTË

PËR ANËTARËSIMIN E SHQIPËRISË NË NATO

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë çmon rëndësinë e jashtëzakonshme që ka për vendin tonë Samiti i NATO-s në prill të këtij viti dhe shpreh mbështetjen e tij të plotë për të gjitha masat e nevojshme dhe të domosdoshme që duhen realizuar, që në këtë Samit Shqipëria të marrë ftesën historike për anëtarësim në NATO, si dhe garanton gatishmërinë dhe vendosmërinë e tij për të kryer të gjitha detyrimet që i takojnë në këtë proces.

Kuvendi i Shqipërisë,

- duke qenë i vendosur në rrugën e natyrshme të Shqipërisë për t'iu bashkuar familjes euroatlantike, si një hapësirë e patjetërsueshme lirie dhe demokracie, ku shqiptarët, si popull që mbështet gjerësisht anëtarësimin në NATO, shohin të ardhmen demokratike të vendit të tyre;

- duke shprehur mirënjohjen për ndihmën e madhe që NATO-ja dhe vendet anëtare i kanë dhënë Shqipërisë në të gjitha etapat dhe programet e deritanishme të procesit për anëtarësim dhe duke rikonfirmuar mbështetjen për arritjet e shënuara nga vendi ynë në këtë proces;

- duke qenë i vetëdijshëm se ftesa e shumëpritur për anëtarësim në NATO kërkon angazhimin dhe bashkëpunimin e pandërprerë të të gjitha forcave politike parlamentare;

- duke qenë i ndërgjegjshëm për vështirësinë e kësaj sfide të përbashkët dhe i vendosur për ta përballuar atë në kushtet kur vendi ka ende shumë për të bërë në rrugën e ndërtimit të një demokracie funksionale e të një sistemi politik të bazuar në ekonominë e tregut;

- shpreh bindjen për domosdoshmërinë e kapërcimit të konfliktualitetit politik, në emër të klimës së besimit mes forcave politike parlamentare, për të gjitha reformat e nismat ligjore, që në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë kërkojnë konsensus të gjerë;

- angazhohet me të gjitha kapacitetet e tij për të ndihmuar në realizimin e reformës në drejtësi dhe të reformës zgjedhore, në përputhje me standardet e familjes euroatlantike;

- vlerëson arritjet e deritanishme dhe u shpreh solidaritet e mbështetje të plotë Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, duke i inkurajuar të përmbushin detyrimet e procesit integruar në NATO;

- shprehet i gatshëm të mbështesë çdo nismë që përshpejton hapat integruar në NATO dhe nxit Qeverinë, institucionet e tjera shtetërore dhe shoqërinë civile për këtë qëllim;

- konfirmon qëndrimin e tij të vendosur për paqe, siguri, stabilitet, mirëkuptim e bashkëpunim rajonal, që konsolidohet më tej me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, si rrjedhojë logjike e dinamikës së zhvillimeve rajonale dhe angazhimit të drejtpërdrejtë të NATO-s.

21 janar 2008